



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-
KOMISIONI I KONKURENCËS

Datë 05/10/2016

NJOFTIM PËR SHTYP

Miratimi i Rregullores: “Mbi procedurat e angazhimeve”

Komisioni i Konkurrencës në mbledhjen e tij të radhës në datë 05.10.2016, miratoi Rregulloren “Mbi procedurat e angazhimeve”. Bazuar në eksperiencat e Autoritetit të Konkurrencës si dhe në të drejtën Europiane të Konkurrencës, është hartuar kjo rregullore e cila synon të mundësojë përdorimin e instrumentit të angazhimeve që mund të marrin ndërmarrjet para Komisionit të Konkurrencës për të korrigjuar sjelljet e tyre që mund të kenë efekte negative në treg. Ky instrument do të rrisë eficiencën e zbatimit të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Pra, Rregullorja ka për objekt përcaktimin e rregullave dhe të procedurave që zbatohen në rastet e përfundimit dhe mbylljes së procedurave hetimore nëpërmjet vendimeve me angazhime, kur angazhimet eliminojnë shqetësimet e ngritura të konkurrencës, të identifikuar nga Autoriteti i Konkurrencës, në përputhje me Ligjin nr 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar) (nenin 45). Hartimi i kësaj rregulloreje, synon përafrimin e legjislacionit shqiptar me atë europian në fushën e konkurrencës në zbatimin e atyre rasteve kur angazhimet eliminojnë problemet e konkurrencës të identifikuar nga Autoriteti i Konkurrencës.

Sipas kesaj Rregulloreje, nje vendim me angazhime, paraqet angazhimet e propozuara nga ndërmarrja, të cilat duke qene detyruese, krijojnë siguri ligjore, rivendosin konkurrencën në treg dhe sigurojnë ruajtjen efektive të saj në mënyrë të vazhdueshme.

Në rastet e marrjes së një vendimi me angazhime, nuk është e domosdoshme kryerja e procedurave të plota hetimore. Vendimet me angazhime nuk kërkojnë të zbatohen të gjitha hapat procedurale që do të zbatoheshin në rastin e një vendimi përfundimtar. Rastet e “zgjidhjes me angazhime” mund të sjellin një ndryshim më të shpejtë dhe efektiv në treg. Angazhimet nuk përcaktohen nga Komisioni, por depozitohen vullnetarisht dhe vendosen vetëm pas diskutimit me palët objekt hetimi.

Nëpërmjet kësaj Rregulloreje janë përcaktuar edhe dispozitat procedurale mbi fillimin e diskutimeve për angazhimet dhe organizimin e takimeve midis palëve të interesuara dhe Autoritetit të Konkurrencës., është sqaruar zbatimi dhe monitorimi i angazhimeve në këndvështrimin e konkurrencës, të cilat janë jetike për efencën e ndërhyrjes së Autoritetit të Konkurrencës në treg.

Komisioni i Konkurrencës vendosi që në takimet me përfaqësues të biznesit që do të mbahen në të ardhmen nga institucioni, të bëhet me dije dhe të diskutohen përftimet e ndërsjellta që sjell kjo rregullore dhe zbatimi i saj.